

## **DHOMA SHQIPTARE E ARBITRAZHIT** (Albanian Chamber of Arbitration)

### **KODI I ETIKËS PËR ARBITRAT**

1. Arbitri i emëruar në procedurat e arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit, pavarësisht nëse është caktuar nga një palë apo nga një gjykatë kombëtare ose autoritet tjetër, duhet të respektojë, krahas detyrimit të përgjithshëm të mirëbesimit edhe këtë Kod Etike për të cilin ai konsiderohet se ka dhënë pëlqimin me pranimin e emërimit të tij si arbitër dhe ka marrë përsipër ta respektojë në kryerjen e kësaj detyre, siç parashikohet nga Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Kombëtare të Arbitrazhit.
2. Arbitri merr përsipër që, në kohën e emërimit të tij si arbitër ose kurdo që kjo i kërkohet nga Dhoma, të bëjë një deklaram të plotë të konflikteve të mundshme të interesit apo papajtueshmërive që ai mund të ketë duke plotësuar formularin përkatës bashkëngjitur. Në rast dyshimi, është me vend që të gjitha rrethanat që mund të jenë me rëndësi të përmenden nga arbitri në deklaramin e tij.
3. Pa qenë nevoja që kjo të kërkohet nga Dhoma, arbitri deklaron të gjitha ndryshimet e mundshme apo faktet e reja që mund të lindin eventualisht dhe që mund t'u japin shkas dyshimeve në lidhje me paanësinë, pavarësinë ose neutralitetin e tij.
4. Pranimi i emërimit si arbitër përfshin detyrimin, në kohën e emërimit dhe gjatë zhvillimit të procedurave, si dhe gjatë dy viteve që pasojnë mbylljen përfundimtare të procedurave të arbitrazhit:
  - a. për të pranuar rregullat që zbatohen për procedurat
  - b. për të qenë i pavarur nga palët në mosmarrëveshje, nga çdo palë e lidhur me to dhe nga financuesit e tyre palë të treta, nëse ka të tillë, si dhe nga çdo person tjetër i lidhur me to, dhe nëse palët janë persona juridikë, nga aksionarët, drejtuesit, punonjësit, këshilltarët, konsulentët dhe përfaqësuesit e tyre;
  - c. për të qenë dhe për të qëndruar i paanshëm dhe për të mos pasur asnjë interes financiar apo personal mbi mosmarrëveshjen apo mbi rezultatin e saj;
  - d. për të qenë neutral dhe jo i njëanshëm;
  - e. për të pasur njohuri të mjaftueshme mbi fushën e mosmarrëveshjes;
  - f. për të qenë i aftë për ta trajtuar çdo procedurë arbitrazhi personalisht, duke i kushtuar asaj të gjithë kohën e nevojshme, pa deleguar në asnjë mënyrë analizimin e çështjes dhe hartimin e vendimit;
  - g. për të mos qenë partner, ortak, koleg i një pale ose i përfaqësuesit të saj apo i një të afërmi ose miku të afërt të ndonjërit prej tyre ose që ka interesa ekonomike, profesionale ose personale në lidhje me ndonjë prej tyre apo që punon vetë ose ka një partner apo ortak që punon në të njëjtën zyrë, korporatë, subjekt apo aktivitet me ndonjë prej tyre, ose që ka vepruar ose ka në zyrën apo organizatën e tij dikë që ka vepruar në emër të personit që e ka emëruar atë apo të personit juridik që është i lidhur me të;
5. Me pranimin e emërimit, arbitri merr përsipër t'i kryejë detyrat e tij si arbitër
  - a. duke ruajtur pavarësinë, paanësinë dhe neutralitetin për periudhën e lartpërmendur



- b. duke vepruar në mënyrë të kujdesshme e të drejtë;
  - c. duke i zhvilluar procedurat me shpejtësi dhe efikasitet, në përputhje me marrëveshjen dhe rregullat e arbitrazhit;
  - d. duke mos vepruar si përfaqësues, këshilltar, konsulent ose punëdhënës apo punëmarrës i asnjë prej personave dhe subjekteve të lartpërmendura për dy vite pas përfundimit të këtyre procedurave të arbitrazhit
  - e. duke zbatuar përkatësisht legjislacionin e zbatueshëm (ose parimin *ex aequo et bono* [heqja dorë nga ndjekja strikte e ligjit] nëse palët kanë vendosur kështu);
  - f. duke vendosur një dialog konstruktiv me palët;
  - g. duke përmbushur mandatin e tij dhe duke e zgjidhur mosmarrëveshjen me anë të marrjes së një vendimi i cili ka fuqi detyruese në selinë e procedurave të arbitrazhit dhe në vendbanimin e palës humbëse;
  - h. duke ruajtur konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë gjatë procedurave të arbitrazhit, si dhe pas marrjes së vendimit;
  - i. duke i dhënë përparësi detyrës së tij mbi përfitimet e tij personale të çfarëdolloj natyre dhe duke i dhënë përparësi të plotë të drejtave të palëve, duke u dhënë atyre mundësi të arsyeshme për të paraqitur dhe provuar pretendimet e tyre dhe për t'iu përgjigjur atyre të palës kundërshtare;
  - j. duke respektuar plotësisht të drejtat e palëve, duke i dhënë secilës prej tyre mundësi të arsyeshme për të paraqitur dhe provuar pretendimet e saj dhe për t'iu përgjigjur palës kundërshtare;
  - k. duke i dhënë përparësi asaj që pala dëshiron të përcjellë mbi kuptimin fjalë për fjalë të deklaratave dhe zotimeve të tyre dhe të dispozitave ligjore;
  - l. duke i ftuar palët që, kur është e mundur, ta zgjidhin mosmarrëveshjen miqësisht ose t'u nënshtrohen procedurave të ndërmjetësimit;
  - m. duke marrë pjesë në mënyrë konstruktive në arsyetimet e trupës gjyqësore të arbitrazhit;
  - n. duke mos harruar se palët ja kanë referuar mosmarrëveshjen arbitrazhit sepse dëshirojnë një procedurë të ndryshme dhe më të mirë se ajo gjyqësore.
  - o. duke refuzuar çdo detyrë të re që nuk e lejon atë të ushtrojë detyrën e pranuar me qetësinë e duhur shpirtërore dhe duke i kushtuar asaj kohën e nevojshme
  - p. duke mos pranuar udhëzime të tjera nga palët gjatë procedurave dhe gjatë dy viteve që pasojnë
  - q. duke siguruar që të mos ketë kontakte me vetëm një nga palët ose që përfaqësuesi i kësaj pale të mos ketë kontakte me vetëm një prej bashkëarbitrave të tij.
  - r. duke marrë në konsideratë propozimet që mund të bëhen nga ndërmjetësi në kohën e alokimit të kostove dhe tarifave të procedurave të arbitrazhit.
  - s. duke nxitur minimizimin e kostove.
  - t. duke mos i deleguar asnjë kolegu, asistenti, sekretari të Dhomës ndonjë prej detyrave të tij si arbitër.
6. Shkelja e ndonjë prej detyrimeve të mësipërme përbën shkak të arsyeshëm për shkarkimin e arbitrit.
7. Nëse arbitri nuk përmbush qoftë edhe vetëm një prej kërkesave të lartpërmendura, ai duhet ta refuzojë emërimin.

8. Në rast se është në dyshim nëse duhet ta deklarojë apo jo një rrethanë, arbitri duhet ta deklarojë atë.
9. Në rastin e një dyshimi të arsyeshëm lidhur me paanësinë, pavarësinë ose neutralitetin e tij, rekomandohet që arbitri ta refuzojë emërimin ose të heqë dorë.
10. Nëse të gjitha palët, arbitrat dhe Dhoma janë në dijeni të një shkakut për mospranimin ose heqjen dorë nga emërimi, dhe të gjithë e pranojnë atë, atëherë arbitri nuk duhet ta refuzojë emërimin ose të heqë dorë prej tij, përveç rastit kur ai e dëshiron këtë.
11. Në rast se arbitri ndodhet në shkelje ose në mospërbushje të ndonjë prej këtyre detyrimeve, kjo do të përbëjë shkak për largimin e tij dhe Dhoma do të ketë të drejtën ta shkarkojë (dhe, rëndësisht, të emërojë një arbitër të ri, të pretendojë kthimin e çdo shume që i është paguar atij dhe të mos pranojë më emërimet e ardhshme të personit në fjalë si arbitër), si dhe të pretendojë dëmshpërblime të tjera.
12. Arbitri do t'i bashkëngjisë deklaratës së tij të pranimit, Zotimin dhe Shtojcat e tij, të plotësuara dhe të nënshkruara nga ai vetë.
13. Nëse një marrëveshje arbitrazhi parashikon disa arbitra dhe secila palë emëron arbitrin e vetë, ndërsa arbitrat e emëruar prej palëve emërojnë arbitrin e tretë, të gjitha këto emërimet do t'i nënshtrohen miratimit të Dhomës.
14. Arbitri ka për detyrë të respektojë palët dhe Përfaqësuesit e tyre dhe të drejtën e tyre për të paraqitur dhe provuar pretendimet e tyre, të dëgjojë kërkesat e palëve dhe për të mos mbajë qëndrime paragjyquese. Ai duhet të marrë një vendim brenda afatit kohor të përcaktuar nga Rregullat, duke shmangur vonesat. Arbitri duhet të lejojë ndryshimin e pretendimeve dhe paraqitjen e dokumenteve të reja, për sa kohë që këto nuk shkaktojnë vonesa të konsiderueshme në zhvillimin e procedurave. Në veçanti, ai cakton datat e seancave dhe zhvillimin e procedurave duke siguruar barazi midis palëve dhe duke garantuar mbarëvajtjen e debatit dhe pajtueshmërinë absolute me parimin e procesit të rregullt.
15. Në vlerësimin e tarifave procedurale, arbitri merr në konsideratë propozimet e mundshme të bëra nga një ndërmjetës, por duke ruajtur të drejtën për të mos i ndjekur ato.
16. Arbitri bashkëpunon për të minimizuar sa më shumë kostot procedurale.
17. Arbitri ka të drejtën
  - a. të marrë masa të ndërmjetme, përveçse në sistemet ligjore që nuk e njohin këtë të drejtë për arbitrat
  - b. të marrë në mënyrë të përshpejtuar një vendim të pjesshëm, nëse një pjesë e pretendimeve janë qartazi të bazuara
  - c. të marrë një vendim të pjesshëm - nëse kjo i kërkohet - i cili e ngarkon palën që nuk e ka paguar pjesën e saj të paradhëniesve ose kostove procedurale, me detyrimin për t'ia rimbursuar ato palës që i ka parapaguar ato në vend të palës tjetër.

Ky Kod hyn në fuqi me datë 01.06.2022.

*Miratuar me vendimin Numër 1/1, datë 30/05/2022 të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit*